

Shërbime të sance  
plenare



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike

Nr. 3306 Prot.

Tiranë, më 02.09.2024

**Lënda:** Kërkesë për interpelancë urgjente me ministrin Petrit Malaj.

**Drejtuar:** Znj. Elisa SPIROPALI  
Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë

**Këtu**

Znj. Kryetare e Kuvendit,

Gjykata Kushtetuese në 27 qershor 2024 lajmëroi vendimin e saj për shfuqizimin, të ligjit nr. 29/2023, datë 30.03.2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar, në vendimin e zbardhur në 30 korrik me nr. 52, Gjykata Kushtetuese ka argumentuar përfundimisht antikushtetueshmërinë e ligjit. Në ndërkohë që çështja ishte dërguar nga Partia Demokratike dhe që mbështetur gjithashtu edhe nga tre shoqata të ndryshme që përfaqësonin "profesionistët e lirë" dhe në ndërkohë që çështja po shqyrtohej me shpejtësi nga Gjykata Kushtetuese, qeveria shqiptare përmes administratës tatimore dërgonte e-maile kujtuese për subjektet e këtij ligji që ishte në shqyrtim nga Gjykata Kushtetuese për pagesën e kësteve.

Nën presionin e kërkesave dhe emaileve që administrata tatimore i drejtoi subjekteve nga kjo fashë, thuajse 10 mijë të tilla, kanë kryer pagesën e tyre në drejtorinë e Tatimeve ndonëse Gjykata Kushtetuese e shpalli pak ditë më vonë ligjin si antikushtetues duke shfuqizuar pikat kryesore të tij. Megjithëse Gjykata Kushtetuese e ka zbardhur vendimin e saj duke sqaruar plotësisht argumentet ligjore, sot e kësaj dite profesionistët e lirë që u shtrënguan të paguajnë një këst për një ligj antikushtetues paratë e tyre ende nuk janë kthyer. Kësisoj veprimi i qeverisë mbetet tërësisht në antikushtetueshmëri përderisa Ministria e Financave duhet të kishte përgatitur me çdo mënyrë hapat që duhet të ishin ndjekur që venimi i padrejtë për të marrë paratë të korrigohej. Një akt i tillë është i domosdoshëm jo vetëm sepse ligji tanimë është antikushtetues por edhe sepse presioni i ushtruar ndaj këtyre subjekteve është kryer në kundërshti me logjikën e ngjarjeve.

Në këto kushte, me qëllim dhënien e informacioneve dhe shpjegimeve lidhur me sa më lart, në cilësinë e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, në mbështetje të nenit 80, pika 1, të Kushtetutës dhe nenit 97, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, kërkojmë zhvillimin e një interpelance urgjente me ministrin e financave z. Petrit Malaj. Interpelanca do të paraqitet nga deputetja Jorida Tabaku.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

**KRYETARI**

**Gazment BARDHI**

**DEPUTETE**

**Jorida TABAKU**